



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 08 maj 2019, në mbledhjen e XIX (nëntëmbëdhjetë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;20 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës (Lista e nënshkrimeve). Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, të gjithë Drejtorët e Drejtorive, Veton Vehapi përfaqësues i OSBE-së, përfaqësues të OJQ-ve lokale (Rrjet i OJQ Lokale), përfaqësues të KFOR-it përfaqësues të mjeteve të informimit dhe mediave, dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, i njoftoi rreth pikave të rendit të ditës dhe konstatimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe shtoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron të marr fjalën.

z.Vendenis Lahu, theksoi, unë si këshilltar i Kuvendit të Komunës dhe përfaqësues i LVV-së, në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, neni 47 paragrafi 2, propozoj që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë, propozim vendim i cili literaturën e Bibliotekës së Qytetit ta zhvendosin në hapësirat e brendshme të shkollave "Naim Frashëri" dhe "Shaban Shala", si dhe ambientet e brendshme të këtyre dy shkollave, pas përfundimit të vitit shkollor 2018/2019 të ofrohen në shërbim të shfrytëzuesve të Bibliotekës. Të nderuar, siç jemi në dijeni Biblioteka e Qytetit nuk është funksionale, andaj mendoj se është momenti i duhur që literatura dhe hapësira për lexim t'iu ofrohet lexuesve të qytetit tonë, prandaj ju ftoj të gjithëve ta votoni këtë propozim vendim, si pikë shtesë e rendit të ditës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse ndokush dëshiron të marrë fjalën rreth kërkesës së përfaqësuesit të LVV-së për një pikë shtesë në kuadër të rendit të propozuar të ditës, urdhëroni.

z.Avni Fetahu, theksoi, kohëve të fundit është bërë paksa veçori që të paraqiten propozim vendime qysh në fillim të mbledhjeve, gjë e cila paksa po na vështirëson punën e që herëve tjera ndoshta do të ishte mirë që propozime të tilla të paraqiten fillimisht në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa që do të na lejonte mundësinë e diskutimit paksa më të gjerë dhe më në detaje. Në këta pak minuta para fillimit të kësaj mbledhjeje ne morëm informata nga Drejtoritë përkatëse të cilat na informuan se së shpejti planifikohet bartja në objektin e ri të Komunës, në të njëjtën kohë është paraparë një vend më i mirë i mundshëm që të vendoset literatura e Bibliotekës së Qytetit. Kërkesa në fjalë është shumë e mirëpritur dhe shumë e domosdoshme dhe nuk po e kundërshtojmë ne, mirëpo pas përfundimit të vitit shkollorë 2018/2019, deri atëherë mund të ndodh që të bëhet bartja brenda këtij objekti, kështu që një lëvizje e tillë vetëm sa do ti shkaktonte telashe Drejtorisë së

Kulturës Rinisë dhe Sportit e cila ndoshta së bashku me Drejtorinë e Administratës mund të na njoftojnë më në detaje, mirëpo ne paraprakisht morëm informata se së shpejti do të bëhet bartja në objektin e ri të Komunës dhe literatura do të zhvendoset në vendin më atraktiv të mundshëm në këtë objekt ku jemi tani.

z.Vendenis Lahu, theksoi, vetëm deshta të shtoj që ne presim që Komuna të bëjë një zgjidhje afatgjate. Propozimi im është për një zgjidhje afatshkurtër. Nuk e di se sa do të mund të zhvendoset brenda një kohe të shkurtër Biblioteka e Qytetit në objektin e Komunës ku jemi tani, andaj për këtë arsye edhe kam përgatitur një propozim vendim të tillë që të paktën deri në përfundim të vitit shkollorë të ndodh një gjë e tillë, pastaj nëse bëhet ajo që parafolësi e ceku do të ishte edhe më mirë, kështu që nuk kemi tjetër çfarë të shtojmë por vetëm të hedhet në votim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë parafolësi insistoj të hedhet në votim pa një diskutim më të gjerë, unë e hedh në votim propozimin vendimin në fjalë që të përfshihet në rend të ditës të kësaj seance.

z.Bajram Ajeti, theksoi, këshilltari z.Avni Fetahu e tha që para fillimit të kësaj mbledhje morëm informata nga Drejtorët e Drejtorive përkatëse, andaj unë kërkoj nga ata Drejtor që të marrin fjalën dhe të japin informata.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se meqë, 16 vota ishin për, 18 vota kundër dhe asnjë votë e përmbajtur, nuk kalon propozim vendimi i paraqitur nga përfaqësuesi i LVV-së, për përfshirje si pikë shtesë në kuadër të rendit të propozuar të ditës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit u konstatua se me 18 vota për, 10 vota kundër, dhe 6 vota të përmbajtura, u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe pikave të parapara së bashku me materialin përkatës dhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

1. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 04 mars 2019; 11 mars 2019 (e jashtëzakonshme); dhe 29 mars 2019

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi tri Ekstrakte të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara, të cilat besoj që i keni lexuar, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo i hedh, në pako tri procesverbalet sipas kësaj pike, duke kërkuar që në konstatimin e votimit në pikën 7 të Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 04 mars 2019, të përfshihet edhe konstatimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL sipas shkresës me nr. protokolli 020-253/4 të datës 05.04.2019.

Pas votimit u konstatua se me 33 vota për, asnjë votë kundër, dhe 1 votë të përmbajtur të znj.Lirika Maliqi, u miratuan:

-Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 04 mars 2019, përfshirë edhe kërkesën e Kryesuesit të Kuvendit.

-Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e mbajtur më 11 mars 2019, dhe,

-Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 29 mars 2019.

2. Propozim Vendimet për miratim paraparak / dhënien në shfrytëzim:

- *Prona e paluajtshme e Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm*
- *Prona e paluajtshme e Komunës në fshatin Dumnicë e Poshtme,*
- *Lokalet në Tregun e Qytetit, dhe*
- *Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim KEDS-it*

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para vetës keni 4 propozim vendime të Kryetarit të Komunës, të cilat presin miratimin nga ana juaj. Ashtu siç e ceku Kryesuesi i Kuvendit, kemi të bëjmë me dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, dhe atë, në fshatin Lupç i Poshtëm, parcela 495/1 nga e cila do të jepet në shfrytëzim afatshkurtër 15 vite, 20 ari apo 2000 m² për qëllime biznesore.

Propozim vendimi i dytë bëhet fjalë për fshatin Dumnicë e Poshtme, parcela 74/1 e cila do të jepet në shfrytëzim afatgjatë 99 vite, sërish 20 ari apo 2000 m² për qëllime bujqësore.

Pastaj kemi propozim vendimin e tretë me të cilin bëhet fjalë për Tregun e Qytetit e që është e nevojshme të miratohet ky propozim vendim në mënyrë që Komisioni vlerësues ti vë në ankand publik apo me njoftim publik lokalet e pashfrytëzuara në mënyrë që Tregu i Qytetit të jetë i funksionalizuar. Vlen të theksohet se ashtu siç jeni në dijeni shumica prej juve, Tregu në fjalë përkatësisht 35 lokalet afariste n'kuadër të tij, janë lëshuar në përdorim në vitin 2012, dhe në këtë aspekt jemi dëshmitarë që më shumë se gjysma e tyre janë jo funksional, andaj në mënyrë që të bëhen funksional dhe që atyre që dëshirojnë të punojnë dhe që kanë leverdi, të krijojnë të ardhura për vete si dhe Komuna të krijoj të ardhura njëkohësisht nga qiraja.

Sa i përket propozim vendimit të 4-të, kemi të bëjmë me dhënien e pronave - pjesëve të rrugëve publike të cilat sipas Ligjit për rrugët, menaxhohen nga Komuna, KEDS-it e cila ka paraqitur kërkesë për 8 lokacione të ndryshme për 11 trafo, që do t'i jepet kësaj Kompanie në shfrytëzim afatshkurtër 15 vite.

z.Bajram Ajeti, theksoi, mendoj se këto propozim vendime është mirë të mos shkojnë në pako, por secila veç e veç të diskutohet dhe pastaj të votohen. E them këtë sepse specifikat e dy nënplikave të para, përkatësisht për fshatrat Lupç i Poshtëm dhe Dumnicë e Poshtme dallojnë prej propozimit për lokalet në Tregun e Qytetit por edhe prej propozimit për dhënie e pronave të paluajtshme KEDS-it.

Do të ishte mirë që për Tregun e Qytetit, Drejtori i Drejtorisë përkatëse të na sqaroj paksa, si qëndron kjo çështje, përse ka dështuar ai Treg, si qëndron çështje rreth pagesave të qirasë për të cilën mund të diskutojmë se çfarë mund të bëjmë, t'iu falen borxhet atyre që janë aktualisht shfrytëzues të tyre e që ekziston mundësia e faljes së borxheve të atyre që kanë shfrytëzuar deri më tani. Po ashtu kur jemi tek kjo pikë unë kam një shqetësim që dua të ndërlihdë me këtë temë, fjala është për pastërtinë dhe për Tregun e bulmetrave. Mua më kujtohet kur para rreth 30-35 viteve ka pasë të ashtuquajtur qilerë ku janë shitur bulmetrat, kurse sot siç mund ta shohim ekziston një gjendje ku vetëm rruga i ndanë kontejnerët e mbeturinave dhe vendet ku shiten bulmetrat, problem ky i cili është i Komunës e jo i atyre që janë aktualisht apo atyre që do të marrin në të ardhmen në shfrytëzim ato prona, pra është shumë problem akut i cili ndërlihdet me Tregun e Qytetit e që mendoj se është detyrë edhe e Inspektoratit të Punës që të konstatoj këto gjëra. Kështu që për dy nënplikat – propozim vendimet e para mendoj se është në rregull që të miratohen si vendime paraprahe, andaj kërkoj që secili propozim vendim të hedhet veçmas në votim. Kurse për KEDS-in, sigurisht që jeni në dijeni për qëndrimin tonë si LVV, meqë KEDS është Kompani private e cila shfrytëzon qytetarët edhe sa i përket çmimeve të energjisë por edhe me forma, metoda dhe praktika tjera, andaj parapraakisht e them se propozimin për dhënien e pronave të paluajtshme KEDS-it ne LVV nuk do t'i votojmë.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit LDK i përkrah propozim vendimet për dhënien e pronave të paluajtshme të cilat i potencoj Drejtori i DPKGJ në fjalën hyrëse dhe të cilat janë në materialin përkatës të kësaj pike, natyrisht duke kërkuar zbatimin e parimeve bazë të cilat janë n'kuadër të Ligjit për dhënien e pronave në shfrytëzim, andaj ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së, përveç që i përkrahim këto propozime, do të përcjellim me vëmendje edhe shfrytëzimin e këtyre pronave, efektin e tyre që do të krijohet si në punësim ashtu edhe në realizimin e të hyrave vetanake që krijohen për Komunën nga dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, natyrisht se dhënia e pronave në shfrytëzim me qira do të rritë edhe të hyrat vetanake të Komunës të cilat janë në interes të qytetarëve. Besoj se punën më të madhe do ta ketë Komisioni për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim. Unë edhe në mbledhjen e KPF-së e kam ngritur çështjen dhe kam kërkuar që Ekzekutivi i Komunës të sjellë kriteret para Komisioni në mënyrë që Komisioni të jetë më efikas në kryerjen e detyrave. Lidhur me propozim vendimin për pronën në fshatin Lupç i Poshtëm ku është propozuar të jepet në shfrytëzim prona prej 20 ari, në bazë të kërkesës për një fabrikë për përpunimin e drurit, mendoj që nëse qiramarrësi është serioz besoj që do të rritet edhe punësimi i atyre qytetarëve të asaj ane do të zvogëlohet sado pak numri i të papunëve, kurse sa i përket kriterëve është mirë që Ekzekutivi ti vë kriteret dhe Komisioni të kryej punën. Në atë lokalitet është edhe fabrika e peletit në pronën që është dhënë më përpara në shfrytëzim, besoj që Drejtoria përkatëse e ka në mbikëqyrje inkasimin e të hyrave të qirasë. Gjithashtu jam plotësisht për mbështetje të dhënies së pronës në fshatin Dumnice e Poshtme - në brezin kufitarë dhe do të kërkoja që të stimulohen me të gjitha format institucionale çdo banorë i Komunës së Podujevës i cili jeton në brezin kufitar, qoftë për arsye kombëtare qoftë lokale, me forma të subvencioneve por edhe në aspektet tjera që lejohen me ligje dhe akte tjera nënligjore.

Sa i përket Tregut të Qytetit dhe lokaleve që janë në treg, mendoj se duhet të jepen në shfrytëzim me qira në mënyrë që të mos rrinë ashtu vetëm si formë e infrastrukturës së ngritur dhe sado pak të ketë inkasim të qirasë. Është e vërtetë se nuk ka funksionuar Tregu si duhet deri tani, nuk ka pas inkasime të mjeteve nga qiratë apo mund të themi se deri tani ka qenë minimal, por është mirë të rishikohen format e dhënies në shfrytëzim, afati i kohëzgjatjes punë kjo e cila do të jetë e Komisionit në bashkëpunim me Ekzekutivin e Komunës që të harmonizojnë format, kohëzgjatjen, çmimet, dhe kujt i jepen ato lokale dhe sa do të jenë serioz qiramarrësit në mënyrë që të mos japim edhe për një mandat dhe të mos mund të inkasojmë mjaftueshëm të hyra. Është mirë të rishikohet çështja e inkasimit të qiramarrësve të mëhershëm që ata të barazohen me borxhe në mënyrë që të mos lëmë barra financiare për arsye se, shembull, KEDS të mos mund të shkëput rrymën në ato orë që janë të regjistruara ose duhet të ndërrohen njehsorët sepse borxhet duhet të jenë zero zero, mirëpo si do qoftë ky propozim vendim duhet të miratohet në mënyrë që të vazhdohet me punë dhe procedura tjera në funksion të dhënies në shfrytëzim lokalet në Tregun e Qytetit.

Sa i përket kërkesës së KEDS për energji të ripërtitshme, mendoj se është interes i të gjithëve energjia e ripërtitshme, sa unë e kam kuptuar Drejtorin e DPKGJ i cili e tha se kërkesa e KEDS është për energji të ripërtitshme. Është e vërtetë që në Komunën e Podujevës janë bërë investime, janë bërë edhe kërkesa për vendosjen e rreth 20 trafave të reja, e që me vendimin e këtij Kuvendi ata qytetarë të atyre rajoneve do të kenë përforsim të energjisë elektrike qoftë për nevoja të amvisërisë qoftë për nevoja të bizneseve që zhvillojnë. Nuk do të doja të lëshohem sa i përket KEDS-it, vendimeve apo çështjes së operimit të kësaj Kompanie në nivel Komune apo më gjerë, mirëpo mendoj se vendosja e rreth 20 trafave në lokalitete të ndryshme është interes sepse rritet cilësia e energjisë elektrike, ngase me një energji të dobët ashtu siç është në disa lokalitete nuk mund të funksionoj asnjë sektor, kurse mbetet përgjegjësi e Drejtorive kompetente që çdo veprim të çdo operatori ta kontrolloj dhe ta mbikëqyrë se si është duke kryer punën e vetë dhe sa është duke

zbatuar ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Kur e them këtë kam parasysh edhe çështjen e vendimeve sa i përket vendosjes së orëve lartë në shtylla për të cilin është dhënë një mendim edhe nga Qendra, andaj mendoj se është mirë që ato vendime të zbatohen. Në parim, mendoj se të gjitha këto kërkesa janë të drejtuara për Kuvendin e Komunës dhe ne tani duhet të marrim vendime, dhe nëse diçka është në kundërshtim është mirë që secili veç e veç t'i japim vërejtjet tona. Unë nuk kam ndonjë vërejtje, me përjashtim të deklarimit të anëtarit të Grupit të këshilltarëve të PDK-së i cili është edhe anëtar i Komisionit për dhënien e pronave në shfrytëzim i cili më ka njoftuar që kemi kërkuar nga Drejtoria përkatëse që të sillen kriteret por që nuk janë sjellë, kështu që kërkoj sërish që në të ardhmen të reflektohet nga ana e Drejtorisë në mënyrë që të mos ngrisim debate të pa nevojshme.

z.Arbër Blaku, theksoi, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës që jam, deshta të shtoj se ndjehem shumë i anashkaluar në këtë proces. Përveç një takimi që jemi ftuar, pothuajse informues, nuk jemi ftuar asnjëherë tjetër. Kërkesa ka qenë që kur të vëhen kriteret nga ana e Ekzekutivit të Komunës, gjë e cila është e rregulluar me ligj, duhet të sjellën në Komision në mënyrë që të analizohen nëse ka ndonjë kriter që mund të jetë diskriminues apo edhe çështje tjera në mënyrë që të rekomandohen nga Komisioni për procesin përkatëse, mirëpo jemi injoruar në total, kështu që tani nga këtu deklaroj se nëse edhe në këtë proces vazhdon i njëjti avaz, unë do të jap dorëheqje nga ai Komision.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, do të thotë u dëgjua shqetësimi i anëtarit parafolës i cili është pjesë e Komisionit për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, i cili a të bëjë me mos përfillje të duhur, ose mos dhënie të kriterëve paraprake nga ana e Drejtorisë përkatëse. Unë e lus Drejtorin e Drejtorisë përkatëse që të përfillen kriteret dhe të gjitha dispozitat ligjore, çfarëdo qofshin ato por që janë në kuadër të dispozitave ligjore.

z.Avni Fetahu, theksoi, meqë po kërkohet që propozim vendimet përkatëse sipas kësaj pike të rendit të ditës, të hedhen në votim veç e veç, atëherë mund të shkojmë në atë formë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pasi që u kërkuar dhe njëkohësisht u pajtuan të gjithë që procesi i votimit për këto propozim vendime të jetë për secilin veçmas, atëherë i hedh në votim secilin propozim vendim veç e veç, sipas kësaj pike dhe materialit përkatës në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës.

-Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se, njëzëri u miratua propozim vendimi për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim, afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm.

-Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se, njëzëri u miratua propozim vendimi për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Dumnicë e Poshtme.

-Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se, njëzëri u miratua propozim vendimi për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Lokalet Afariste në tregun e Qytetit.

-Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se, me 23 vota për, 10 vota kundër, 2 vota të përmbajtura, u miratua propozim vendimi për dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS.

3. Propozim Programi Trevjeçar i Banimit 2019 – 2021 në Komunën e Podujevës

• *Propozim vendimi për vënie në diskutim publik*

z.Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, drafti i Programit në fjalë është hartuar – përgatitur nga një Komision i ngritur nga Kryetari i Komunës. Nga Kuvendi i Komunës kërkohet miratimi i propozim vendimit sipas të cilit lejohet që ky dokument t'i nënshtrohet diskutimit publik ashtu siç është rekomanduar edhe nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Sigurisht keni vërejtur në materialin e dërguar se janë të specifikuar qëllimi, vizioni, misionet, synimet, objektivat, sfidat dhe korniza ligjore. Në fakt tek qëllimi i Programit në fjalë është adresimi i çështjeve të banimit në territorin e Komunës së Podujevës, për zgjidhjen e nevojave të banimit për grupe të caktuara të cilat nuk kanë mundësi ekonomike për të siguruar banimin, pastaj vizioni përfshinë përmirësimin e cilësisë së jetesës, shtimin e sipërfaqeve gjelbëruese dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. Objektivi është që të krijohen kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me normat Evropiane të banimit, të krijohen kushte të banimit për grupe të caktuara të cilët nuk kanë mundësi ekonomike të zgjidhin problemin e banimit. Sfidat që na mbesin neve janë që ende vazhdon një shkallë e lartë e papunësisë, e varfërisë, kostoja e lartë e infrastrukturës e të tjera. Drafti i Programit Trevjeçar i Banimit në Komunën e Podujevës është i bazuar në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, andaj kërkohet miratim nga ana e Kuvendit në mënyrë që ky dokument t'i nënshtrohet diskutimit dhe debatit publik që parashihet të organizohet nga ana e shërbimeve përkatëse komunale dhe pastaj të kthehet sërish në Kuvend për shqyrtim final, përkatësisht miratim të Programit në fjalë i cili ka të bëjë ekskluzivisht me zgjidhjen e problemeve për kategoritë që i ceka më lartë.

z.Bunjamin Hoti, theksoi, tema për të cilën unë do të mbaj qëndrimin në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së është Programi Trevjeçar i Banimit, dokument ky i hartuar nga Komuna e Podujevës në bashkëpunim me Organizatën Developing Together, organizatë kjo me të cilën Kryetari i Komunës së Podujevës z.Agim Veliu ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për përpilimin e këtij Programi, përmes të cilit Komuna e Podujevës do të ketë mundësi që në mënyrë profesionale të planifikoj adresimin e çështjes së banimit për kategoritë e popullsisë që nuk kanë fuqi ekonomike për të siguruar një banim të përbalueshëm. Programi në fjalë është në përputhje të plotë me kornizën ligjore që përbëhet prej 8 ligjeve, andaj ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit LDK i japim mbështetje këtij dokumenti për vënie në diskutim publik ashtu siç është kërkuar, ku edhe do të japim kontributin tonë, prandaj ju ftoj që bashkërisht të mbështesim këtë propozim.

z.Vendenis Lahu, theksoi, në bazë të analizës tonë të këtij dokumenti strategjik, në bazë të asaj që ne shohim çdo ditë, pa dyshim që problematika e banimit është një prej problematikave kryesore në Komunën tonë, njëkohësisht kjo është një tregues që kjo qeverisje lokale përgjatë gjithë këtyre 20 viteve të pasluftës nuk është angazhuar aspak për krijimin dhe implementimin e politikave të banimit dhe si rrjedhojë komplet ky sektor është zhvilluar në mënyrë stihike. Në këtë Program Trevjeçar i cili duket si një përshkrim i problemeve dhe më shumë i ngjan një teksti të shprehur në formë dëshire për rregullimin e këtyre çështjeve sesa një dokumenti strategjik me plan të veprimit për realizimin e objektivave të shprehura. Problemi i banimit në Komunën tonë ndërlihet me shumë aspekte, me mungesë të planeve urbanistike në territorin e Komunës, shkatërrimin e tokës bujqësore nga ndërtimet e pakontrolluara, mungesën e shërbimeve publike në lagjet dhe fshatrat si rezultat i mungesës së planifikimit. Në këto 20 vitet e fundit si Komunë kemi pas problem madhor të banimit

në Lagjen e Dëshmorëve, për shumë kohë Komuna nuk ka ndërmarr asgjë për zgjidhjen e atij problemi dhe si rrjedhojë ky problem është rritur në mënyrë eksponenciale për shkak të rritjeve të familjeve dhe numrit të banorëve gjatë këtyre viteve, mirëpo fare vonë me inicim të nivelit qendrorë dhe participim të Komunës ka filluar projekti i ndërtimit të shtëpive në atë Lagje, e që për hir të së vërtetës, me një sipërfaqe prej 50m² më shumë ngjasojnë me kasolle moderne sesa me shtëpi që do të ofronin zgjidhje afatgjate për ato familje, sepse me shtimin e familjeve për 1-2 anëtar jetesa në një sipërfaqe aq të vogël do të bëhet e pamundur, prandaj kjo nuk është zgjidhje afatgjate dhe Komuna do të përballlet shumë shpejt me raste të reja për banim social nga po ajo Lagje.

Me mjetet që Komuna ka ndarë deri tani dhe me ato që pritet t'i ndaj, fare mirë dhe shumë kohë më parë, përmes dy-tri kompleksesh banesore në pjesë të ndryshme të Komunës do të mund t'ju ofronte zgjidhje afatgjate me hapësira dukshëm më të mëdha të banimit me kosto më të ulët dhe njëkohësisht do të shmangte grumbullimin e të gjithë këtyre banorëve në një vend të vetëm dhe kështu do të shmangte shndërrimin e kësaj pjese të qytetit në një lloj getoje moderne, prandaj inkompetenca kushton. Programin në fjalë ne si LVV nuk e shohim të ndarë nga politikat e përgjithshme të banimit në mënyrë kaq ekskluzive sa është paraqitur në këtë dokument. Mendojmë që Komunës tonë i nevojitet një Plan zhvillimor urban i cili do t'i adresonte problemet e banimit dhe marrjen e të gjitha veprimeve të duhura për zbatimin e atij plani. Në Komunën tonë, e posaçërisht në qytet ka nevojë për ndërtim për shkak të ardhjes së popullsisë prej fshatrave, mirëpo ka mungesë të ndërtimeve të planifikuara të ndërtimeve kolektive dhe ato që janë duke u bërë, shumica prej tyre janë në kundërshtime me planin urban të qendrës së qytetit gjë e cila ngjallë dyshime për ndërtime të lidhura me pushtetin. Mungesa e ndërtimeve sipas standardeve të planit urbanistik në Komunën tonë ka rezultuar me çmime të larta të banesave ku çmimi për m² në qytet është afërsisht 600 €, për dallim nga Komuna siç është ajo e Fushë Kosovës ku çmimi për një banesë është rreth 350 € për m², çmim ky i cili sillet edhe në Komunën e Vushtrrisë, çështje kjo e cila qon në migrim të banorëve nga Komuna jonë në komunat tjera ku mundësit për banim kushtojnë më pak dhe ata që do të largohen do të jenë kryesisht kuadro të qytetit tonë, mjekët, profesorët, IT-të dhe profilet tjera të cilat i shërbejnë mjaft shumë jetës publike në Komunën tonë.

Ne si LVV propozojmë këto politika të banimit;

-Përpilimin e planit hapësinor për qytet dhe fshatra,

-Ndërtimet në qytet të jenë kolektive, jo vetëm në qendër por edhe në lagje tjera,

-Pronat komunale në partneritet me kompanitë private të jepen për ndërtim me ç'rast Komunës do t'i takonin disa banesa të cilat pastaj t'ju jepen në shfrytëzim familjeve në nevojë,

-Të krijohet po ashtu një fond për subvencionim të interesit për familjet të cilat kanë nevojë për banesa.

z.Fatmir Rudari, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së, parimisht e përkrahim çdo iniciativë që zgjidh çështjen e banimit të familjeve në asistencë sociale dhe atyre që kanë nevojë për banim. Unë e kam lexuar këtë dokument disa herë, për shkak të volumit të madh që ka dhe besoj që ta kem kuptuar drejtë. Në këtë dokument kam parë shumë pak zgjidhje për familjet në nevojë dhe jam shumë skeptik që kjo mund të ndodh, dokument i cili më shumë ka të bëjë me profilin e Komunës, pozitën gjeografike, trashëgimin kulturore dhe natyrore, karakteristikat demografike, ambientin biznesor dhe deri në fund ku parashihet një zgjidhje për banorët në asistencë. Prioritet kryesor i këtij Programi thuhet që për periudhën trevjeçare Komuna e Podujevës të jetë në gjendje të ndihmoj 80 deri në 100 familje duke iu siguruar banim social, sipas këtij Ligji, sigurimi i banimit bëhet përmes financimit të Programit të veçantë të banimit me qira ku përfshihen banesa të ndërtuara nga Komuna, ndërsa po në këtë dokument thuhet se Komuna e Podujevës nuk ka banesa të ndërtuara që të mund të lëshoj me qira, por planifikon që shtëpitë në Lagjen e Dëshmorëve t'ju caktohet një

shumë e qirasë, çështje e cila besoj se gjatë diskutimit publik duhet të hiqet sepse nuk besoj që është e drejtë ngase ata banorë që banojnë në Lagjen e Dëshmorëve kanë nevojë të ndihmohen edhe më shumë e jo t'ju caktohet qira për banimin e tyre në atë Lagje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush ka diçka rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë propozim vendim duke përfshirë edhe rekomandimin nga mbledhja e KPF-së rreth diskutimi/debatit publik.

Pas votimit u konstatua se njëzëri miratohet propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Programit Trevjeçar të Banimit 2019-2021, duke përfshirë edhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht që diskutimi publik të zgjatë nga 13 maj 2019 deri më 10 qershor 2019, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 29 maj 2019 në ora 11:00, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

4. Raporti Financiar periudhën janar – mars 2019

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti raportin, ndër të tjera theksoi, raporti përmban aktivitetet financiare të zhvilluara gjatë periudhës janar-mars 2019. Në vazhdim Drejtori foli për shpenzimet e bëra gjatë kësaj periudhe, duke i specifikuar nëpër kategoritë ekonomike sipas burimeve të financimit si dhe duke krahasuar shpenzimet me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Në vijim shtoi, shpenzimet për këtë periudhë kanë arritë shumën prej 3,541,416.00€, dhe atë për paga dhe mëditje 2,971,373.00€, mallra dhe shërbime 234,686.00€, shpenzime komunale 87,108.00€, subvencione dhe transfere 28,740.00€ dhe për investime kapitale 219,658.00 €, e që shprehur në përqindje rezulton me 16% e buxhetit të shpenzuar për këtë periudhë kohore, dhe që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak vërehet një ngritje e shpenzimeve prej 4%. Sa i përket të hyrave vetanake, ndër të tjera theksoi, është realizuar plani vjetor i të hyrave prej 21% apo 337,535.00€, ku krahasuar me periudhën e njëjtë vitit paraprak kemi një rritje prej 25%.

Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi realizuar një donacion në shumë prej 199,656.00€, nga Qeveria e Zvicrës dhe SIDA-Suedeze në emër të grantit të performancës komunale. Po ashtu ju njoftoj se karakteristikë kryesore e këtij raporti është se të hyrat kanë shënuar një progres prej 25% kure shpenzimet prej 4%. Gjithashtu dëshiroj të theksoi se ashtu siç jeni të njoftuar, viti fiskal për vitin 2019 ka filluar pa aprovim të buxhetit për vitin aktual nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kështu që kemi filluar vitin me 1/12 e vitit 2018 për muajt janar dhe shkurtë, ndërsa muaji mars ka filluar me buxhetin e vitit 2019 pas miratimit të Ligjit për Buxhetin.

Për fund mund të konstatojmë se është një raport i cili jep një pasqyrë të qartë të hyrave dhe të dalave për këtë periudhë raportuese.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, raporti financiar për periudhën janar-mars 2019 është shumë i varfër, ndoshta është tregues i varfërisë së punës së pushtetit komunal për këtë periudhë. Ne si LVV në mënyrë të vazhdueshme nga fillimi i këtij mandati kemi paraqitur vërejtjet tona në lidhje me mënyrën se si të paraqitet raporti financiar, ku i mungon qartësia dhe transparenca për opinionin publik, mirëpo fatkeqësisht vërejtjet tona kanë hasur në vesh të shurdhër dhe jo në mirëkuptim nga DBF. Ky tre mujor edhe në bazë të këtij raporti financiar na tregon për fatin tonë të keq se ky pushtet vazhdon keqqeverisjen, ashtu si e ka filluar ashtu edhe donë ta përfundojë e që besojmë fuqishëm që qytetarët kanë për t'ia dhënë fundin këtij pushteti që nuk ka vizion qeverisës. Shpenzimet janë realizuar vetëm në kategorinë e pagave dhe mallrave, ndërsa në kategorinë e investimeve kapitale realizimi mbetet shumë i ulët, ku janë shpenzuar vetëm 219,658.00 €, nga gjithsejtë 6,701,304.00€,

që shprehur në përqindje i bie që janë shpenzuar vetëm 3.27 % e buxhetit total për investime kapitale. Sigurisht se ky tremujor është i papërshtatshëm për disa investime kapitale për shkak të kushteve klimatike, mirëpo ky tremujor duhet të shërbejë për hartimin e projekteve për iniciimin e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratave me operatorët ekonomik për realizimin e projekteve. Në rast se shohim faqen e E-Prokurimit, shohim një numër të vogël të projekteve kapitale që janë shpallur me ofertë publike dhe kjo është shumë shqetësuese kur sot jemi me 8 maj dhe për të gjitha ato projekte për të cilat nuk janë iniciuar procedurat e prokurimit, kontratat në rastin më të mirë mund të fillojnë punën në muajin korrik për realizimin e projektit. Me këtë trend të investimeve, në fund si rezultat suficitit buxhetor do të jetë i pashmangshëm, e që tashmë është bërë një traditë e këtij pushteti të paafte. Ne si LVV propozojmë që, duke u bazuar në planin e prokurimit që është i aprovuar para Kuvendit të Komunës, të paraqitet një raport i detajuar për realizimin e projekteve kapitale, për çdo projekt të raportohet se ku ndodhet faza e realizimit të projektit dhe ku janë arsyet e vonesave.

z.Fatmir Rudari, theksoi, për të bërë një krahasim të raportit financiar të vitit të kaluar për të njëjtën periudhë, rezulton pothuajse të jetë i njëjti në këtë vit. Vërejtjet i kam kryesisht te buxheti për investimet kapitale i cili asnjëherë nuk arrin të shpenzohet në tërësi. Vitin e kaluar në tremujorin e parë kishte arritur të shpenzohet rreth 4%, ndërsa për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 kishte arritur të shpenzohet rreth 10%, kështu që pjesa më e madhe e buxhetit kishte arritur të shpenzohet në tre muajt e fundit, duke mos llogaritur një pjesë të madhe të buxhetit i cili kishte tepruar në mungesë të projekteve dhe të menaxhimit të dobët të Ekzekutivit. Pres që me këtë ritëm që ka filluar e njëjta gjë do të ndodhë edhe në këtë vit, ku për tremujorin e parë të vitit 2019, buxheti për investime kapitale është shpenzuar diku rreth 4% dhe kështu do të vazhdojë deri në fund të vitit ku do të kemi sërish suficit buxhetor. Kam disa pyetje lidhur me raportin, ku thotë; Te shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, do të thotë nuk ka në tre muajorin e parë, ndërsa mëditjet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit figuron një shumë prej 104.00€, nëse ka dikush ndonjë përgjigje lidhur me këtë të na jep, përderisa nuk ka udhëtime zyrtare si mund të ketë mëditje. Në raport figuron ngritje të shpenzimeve të energjia elektrike, uji, shërbime kontraktuese të tjera, e që këto shërbime na përsëriten në çdo raport dhe asnjëherë nuk marrim përgjigje cilat janë këto shërbime kontraktuese të tjera.

z.Isuf Latifi, Drejtor i DBF, theksoi, rreth shpenzimeve për mëditje për udhëtimet zyrtare jashtë vendit që figuron një shumë modeste, udhëtimet zyrtare jashtë vendit mund të jenë me pagesë të 100% të institucionit i cili e dërgon, shembull, Kuvendi i Komunës, ftesa merret prej një institucioni nga jashtë vendit, në këtë rast shpenzimet i bartë institucioni të cilin do ta përfaqësojë, por në shumicën e rasteve në Komunën e Podujevës ndodhë që në këto udhëtime zyrtare shkojnë me ftesë të një organizate apo institucioni tjetër i cili i merr përsipër shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit të atyre zyrtarëve komunal, dhe në këtë rast sipas rregullativës ligjore atij i takojnë shpenzimet vetëm për mëditje jashtë vendit por jo edhe shpenzimet e udhëtimit ose shpenzimet e akomodimit ose edhe shpenzimet tjera.

Rreth shpenzimeve për shërbime kontraktuese tjera këtu hyjnë të gjitha shpenzimet si bartja e mbeturinave, pagat e punëtorëve të angazhuar për shërbime të veçanta, larja e veturave, transporti i nxënësve etj.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse ka të interesuar për të marrë fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë falënderoj Drejtorin e DBF për paraqitjen me kohë të raportit financiar dhe parafolësit për kontributin e dhënë. Vazhdojmë me punë me pikën e radhës.

5. Emërimi i anëtarëve në Komisionet e Aksionarëve në:

- *Ndërmarrjen Publike Stacioni i Autobusëve – Podujevë.....(dy anëtarë/e)*
- *Ndërmarrjen Publike për Banim Sh.A.- Podujevë.....(dy anëtarë/e)*

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë kemi të bëjmë me emërimin e anëtarëve në Komisionet e Aksionarëve të dy Ndërmarrjeve Publike, përkatësisht nga dy anëtarë në dy Ndërmarrje, atë për Banim, dhe në atë të Stacionit të Autobusëve, ndërsa nga një anëtar i cakton Kryetari i Komunës me vendim të veçantë, mirëpo për detaje dhe sqarime tjera shtesë fjalën hyrëse do t'ia jap Drejtorit të Drejtorisë përkatëse.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, kemi të bëjmë me ngritjen e dy Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Komunale sipas kësaj pike të rendit të ditës, përkatësisht emërimin e anëtarëve në këto Komisione sipas Ligjit për ndërmarrjet publike i cili është në fuqi, ndërsa vlen të theksohet se është në procedurë e sipër miratimi i ligjit të ri i cili në esencë do të pësoj ndryshime, mirëpo meqë është në fuqi ende ai që ka qenë ne do të veprojmë në bazë të tij, ku në nenin 5 paragrafi 2 thuhet, kur një Komunë është aksionare në një ndërmarrje publike komunale, të drejtat e aksionarëve do t'i ushtroj një Komision komunal i aksionarëve i cili përbëhet nga; 1- një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe 2- dy anëtarë tjerë të emëruar nga Kuvendi i Komunës. Andaj të nderuar këshilltarë të Kuvendit, nga ju kërkohet që sot të propozoni dhe njëkohësisht të emëroni nga dy anëtarë, nga radhët e Kuvendit, në dy Komisionet e Aksionarëve për dy Ndërmarrjet Publike Komunale.

z.Avni Fetahu, theksoi, pas sqarimeve të dhëna nga Drejtori parafolës rreth emërimit të anëtarëve të Kuvendit në Ndërmarrjet Publike Komunale, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së propozon anëtarët si në vijim:

Në Komisionin e Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Stacioni i Autobusëve në Podujevë, propozohet z.Hasan Ajeti, ndërsa

Në Komisionin e Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike për Banim Sh.A. në Podujevë, propozohet z.Bunjamin Hoti

z.Fitim Haziri, theksoi, këtë pikë të rendit të ditës e kemi shqyrtuar edhe në KPF, dhe pikërisht unë kam thënë se nuk është e thënë që anëtarët të propozohen dhe emërohen vetëm nga radhët e një subjekti politik, nuk jemi ne ata që po dëshirojmë të jenë vetëm nga radhët e LVV-së, andaj lidhur me këtë propozoj që në njërin komision të jetë një anëtar nga radhët e LVV-së kurse në tjetrin të jetë një anëtar nga radhët e PDK-së, dhe atë:

në Komisionin e Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Stacioni i Autobusëve – Podujevë, propozojmë z.Bajram Ajeti, ndërsa në komisionin tjetër të propozohet një anëtar nga subjektet tjera.

z.Fatmir Rudari, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, në Ndërmarrjen Publike Komunale Stacioni i Autobusëve – Podujevë, propozoj z.Rafet Llapashtica, ndërsa në Ndërmarrjen Publike Komunale për Banim Sh.A. – Podujevë, propozoj z.Arbër Blaku.

z.Bajram Ajeti, theksoi, meqë nga opozita janë dy kandidat, për ne Grupin e LVV-së nuk luan rol se të cilit subjekt janë ata, kështu që unë tërhiqem nga kandidatura që paraprakisht u propozova, andaj të mbeten ata dy anëtarë që u propozuan nga këshilltari parafolës, nëse nuk ka edhe ndonjë propozim tjetër në vazhdim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, besoj se u sqaruam, dhe u propozuan anëtarët për dy Komisionet e Aksionarëve në fjalë, në fakt pati propozim edhe nga Grupi i LVV-së por i njëjti u tërhiq nga vetë i propozuari, andaj nëse dëshiron ndokush të marrë fjalën urdhëroni nëse jo i hedh në

votim propozimet e paraqitura nga shefi i Grupit të LDK-së dhe propozimet e Grupit të këshilltarëve të PDK-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri ngritën Komisionet Komunale të Aksionarëve, përkatësisht miratohen propozimet për emërimin e anëtarëve, dhe atë:

-Në Komisionin e Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Stacioni i Autobusëve Podujevë, emërohen, z.Hasan Ajeti dhe z.Rafet Llapashtica.

-Në Komisionin e Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike për Banim, emërohen, z.Bunjamin Hoti dhe z.Arbër Blaku.

6. Zëvendësimi i një anëtari në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB (Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë)

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, rreth kësaj pike të rendit të ditës fjalën ja jap Drejtorit të DSHPMSh i cili njëkohësisht është edhe koordinator në Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi z.Faik Muçiqi.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSh, në cilësinë e koordinatorit të KKSB-së e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, meqë ish Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë z.Bekim Bislimi është ndërruar nga ajo detyrë dhe tani është emëruar komandanti i ri i Stacionit të Policisë në Podujevë z.Bekim Zogiani. Sipas legjislacionit përkatës që rregullon përbërjen e KKSB-së dhe procedurat e emërimit dhe zëvendësimit të anëtarëve, sipas detyrës zyrtare, n'kuadër të KKSB-së duhet të jetë Komandanti i Stacionit të Policisë, andaj duhet të kryhet ky zëvendësim si formalitet që është, konkretisht në vend të z.Bekim Bislimit të emërohet z.Bekim Zogiani.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, besoj se u sqaruam rreth kësaj pike, andaj nëse nuk ka të lajmëruar për të marr fjalën, e hedh në votim zëvendësimin e anëtarit të KKSB-së, përkatësisht zëvendësimin e ish Komandantit të Stacionit të Policisë në Podujevë me Komandantin e ri të emëruar.

Pas votimit, u konstatua se njëzëri mbështetet zëvendësimi i një anëtari të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, përkatësisht, z.Bekim Bislimi, ish Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, zëvendësohet nga, z.Bekim Zogiani, Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë.

7. Të ndryshme

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dëshiroj të paraqes një kërkesë që më kanë dërguar disa banorë të tri fshatrave. Meqë edhe Drejtori i Drejtorisë përkatëse është prezent këtu e pyes atë, a ka hyrë në projeksion një rrugë rreth 600 m, në fshatin Siboc. Sa vërejta në kërkesë ishin të nënshkruar të gjithë përfaqësuesit e fshatrave të asaj ane të cilët i kontaktova në telefon dhe nga ata u njoftova se të njëjtën kërkesë ju kanë përcjellë të gjitha Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit si dhe tek Drejtoria përkatëse. Fjala është për asfaltimin e asaj rruge me gjatësi rreth 600 m, dhe e cila lidh atë pjesë me tri fshatra përreth. Nuk e di a është përfshirë ajo rrugë në këtë fazë apo jo, mirëpo tani të gjitha Grupet besoj se e kanë kërkesën, andaj kërkoj të merret parasysh nga të gjithë duke përfshirë edhe Drejtorinë përkatëse dhe të shqyrtohet mundësia e asfaltimit të asaj rruge.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, përgjigje parafolësit, është e vërtetë që është sjellë një kërkesë e tillë, por nuk kemi mund ta përfshijmë në buxhetin e vitit 2019, kurse me siguri do të jetë në buxhetin e vitit 2020.

Ne do t'i shqyrtojmë maksimalisht të gjitha projektet që janë me rëndësi në mënyrë që t'i përfshijmë në buxhetin e vitit 2020. Sa i përket kërkesës në fjalë, me keqardhje e them, e që edhe atyre banorëve ju kam shpjeguar, që nuk mundet të përfshihet ajo rrugë ngase kemi ende banorë që duhet t'ju rregullohet infrastruktura, është e vërtetë që ajo rrugë lidhë dy fshatra por për momentin kanë mundësi me u lidh me fshatin Gllamnik, Sfeçël dhe me fshatra tjera. Ne nuk hezitojmë që të gjitha rrugët që ka Komuna e Podujevës ti asfaltojmë, dhe bashkërisht do të marrim vendime për një gjë të tillë, mirëpo për momentin është kjo gjendje e cila është sepse kemi ende rrugë që duhet të asfaltojmë të cilat janë më nevojshme për qytetarë.

z.Fitim Haziri, theksoi, dua të ngriti tri çështje, e para ka të bëjë me Planin e punës së Kuvendit të cilin e kemi miratuar bashkërisht e që edhe në mbledhjen e KPF-së e potencova se një dokument të cilin e kemi votuar unanimisht në këtë Kuvend, për çdo muaj është duke u shkelur, ngase janë paraparë pika që duhet të diskutohen në seanca, por që nuk janë përfshirë në rend të ditës. Pra çfarë pritët prej neve kur ne vet ato i kemi votuar dhe nuk po zbatohen.

Çështja tjetër ka të bëjë rreth Ditës së Dëshmorëve, Dëshmorët kanë dhënë më të shtrenjtën, jetën, për të cilën ne sot e gëzojmë lirinë. Është për të ardhur keq që Komuna e Podujevës e neglizhon ditën e 5 majit që është caktuar nga kjo Komunë që në këtë ditë të kujtohet vepra e këtyre Dëshmorëve, dhe nuk ka qenë në gjendje as një program organizativ me bë për këtë ditë. Ne veprën e tyre do ta kujtojmë në çdo hap të jetës, në çdo vendim që e marrim këtu që të jemi më parimor dhe të drejtë, por që nuk ishim në gjendje një program ta bëjmë që është më e pakta që mund të bëjmë. Çështja e tretë ka të bëjë me ambientin, ambienti është e drejtë humane dhe që ne duhet të vendosim bashkërisht për të, e vërejmë që kohën e fundit kur është marrë vendimi që të bëhet plani i ri për grumbullimin e mbeturinave gjendja çdo ditë është keqësuar në Komunën e Podujevës.

I është caktuar Kompanisë “Pastrimi” një territor i madh e që kjo Kompani nuk ka kapacitet të menaxhojë të gjitha mbeturinat në ato pjesë, është mirë që ne si subjekte politike të bëjmë një plan që do ta rregullonte çështjen e ambientit në mënyrë që të kemi një ambient më të pastër, vetëm duhet të ekzistoj vullneti për të gjithë, sepse natyra është pasuri që Zoti na e ka falë dhe duhet ta ruajmë. Nuk është gjendja e mirë, por me vullnetin tonë që të bëjmë një plan që të kemi një ambient më të pastër. Qeveria e Republikës së Kosovës vitin e kaluar mbështeti iniciativën e “Let’s do it Kosovo” e cila i lartësoj dhe pastroj Kosovën por që fatkeqësisht të gjitha ato vende të cilat janë pastruar janë kthyer në gjendje të njëjtë, kjo është shqetësuese. Komuna duhet ti ushtroj kompetencat e saj duke u vënë gjoba të gjithë atyre të cilët e ndotin ambientin.

z.Adnan Zymeri, theksoi, Po paraqes para jush një kërkesë dhe shqetësim në të njëjtën kohë të komunitetit mysliman të Xhamisë së Qytetit “Met Podjeva”. Gjatë bisedave të përditshme me ata persona, si dhe me praktikues të tjerë të fesë Islame të cilët kryejnë ritualet fetare në atë Xhami, shqetësim i tyre ka qenë dhe mbetet një numër i madh i personave që kërkojnë lëmoshë në Xhami dhe në hapësirat për rreth. Meqë me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, kërkimi i lëmoshës është veprimtari i jashtëligjshme dhe destinimi i këtyre fondeve të cilat i grumbullojnë këta persona është i dyshimtë, atëherë në bazë të kompetencave komunale duhet të ndërmarim diçka. Probleme të tilla e tejkalojnë lokalen, mirëpo meqë në Komunën tonë kemi Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, si organ për trajtimin e çështjeve të sigurisë unë kërkoj që KKS-së ti parashtrahet kërkesa për angazhimin e të paktën dy policëve gjatë kohës së xhumasë për ta evituar këtë problem gjatë atij namazi kur numri i atyre personave, që vinë nga qytete dhe etni të ndryshme

arrin rreth 20. Pasi në pikën pararendëse u bo zëvendësimi i menjëhershëm i Komandantit të Policisë mbës me shpresën që edhe kërkesa të realizohet menjëherë.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, deshta të jap disa sqarime sepse u ngritën disa çështje që më së paku janë të sinqerta për mos me thënë krejt të njëanshme politikisht dhe po tentohet të futet ndonjë paqartësi apo të krijohet mjegulli. E para ka të bëjë me 5 Majin Ditën e Dëshmorëve, që absolutisht nuk qëndron dhe është i pa vërtetë konstatimi i këshilltarit z.Fitim Haziri që, Komuna e ka injorua dhe nuk ka organizuar program, nuk e di çfarë kupton ky me program, a nënkupton program me dalje me ndezje fishekzjarrë, a me qitje me revole apo çfarë. Ajo çfarë ka ndodh në Ditën e Dëshmorëve apo më 5 maj, që tash është bërë edhe traditë e që ka qenë propozimi kryesisht nga Komuna e Podujevës atëherë të caktohet një datë e Ditës së Dëshmorëve e që fatmirësisht kjo datë pritet të bëhet në nivel Kombi pasi që në Shqipëri veç bëhet, por do të fillojë edhe në komuna të tjera. Aktivitetet për këtë datë kanë qenë këto, një ditë më herët është filluar me shfaqjen e një dramë e cila ka tematikë edhe për luftën e fundit konkretisht me përdhunimet, pastaj kanë vazhduar me 5 maj me homazhe dhe vënie të buqetave të luleve të freskëta pranë Shtatoreve dhe varreve të Dëshmorëve, fillimisht në Sheshin “Ali Ajet”, në “Sheshin e Dëshmorëve” në afërsi të postës, mandej Kompleksin Memorial në fshatin Lladoc, për të vazhduar në Kompleksin Memorial në fshatin Orllan, dhe pranë Obeliskut të Dëshmorit Afrim Zhitia, si dhe duke përfunduar me vënien e kurorave në Kompleksin Memorial në Penuhë. Në këtë delegacion kanë qenë të ftuar të gjithë shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, siç ka qenë i ftuar edhe përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosjes, por këta e kanë parë të arsyeshme që këtë ditë ta festojnë me partinë e tyre dhe jo të jenë në delegacion zyrtar të Komunës. Në këtë delegacion kanë qenë pjesëmarrës aktiv edhe përfaqësuesit e dy Grupeve të tjera politike, LDK-së dhe PDK-së, po ashtu në këtë delegacion kanë qenë edhe përfaqësuesit e Shoqatave të dala nga lufta. Pastaj programi, i cili ka qenë dy ditë më parë i publikuar në web faqe të Komunës, ka vazhduar me aktivitete tjera kulturore dhe sportive, siç ka qenë promovimi i librit “Vetmia” të ish punëtorit të Komunës profesorit të nderuar, piktorit Bislim Aliu që është bërë në sallën e Teatrit të Qytetit “Avdush Hasani” për të përfunduar me finalen në futboll të vogël, ngase kanë qenë të luajtura me dhjetëra lojërë deri atë ditë, në fshatin Kerpimeh. Prandaj nuk është e sinqertë që të thuhet se Komuna ka injorua Ditën e Dëshmorëve, janë këtu njerëzit prezent që kanë qenë dhe do të ishte mirë që edhe ju të ishit bashkë me neve sepse atë ditë të gjithë do të duhej të ishim të bashkuar.

Sa i përket çështjes së dytë rreth ambientit, edhe kjo si duket me çdo formë tentohet të politizohet por që nuk është në rregull, nuk do të ishte mirë sepse po ju informoj shkarazi se po të ketë nevojë ne do të bëjmë edhe raporte për çështjen e Kompanisë “Pastrimi” që është Kompani Rajonale, si dhe çështjen e Kompanisë private “Natyra”. Ne kemi qenë ata që e kemi përkrahë dhe e kemi mbështet Kompaninë private “Natyra”, pas licencimit të saj i kemi jap leje të përkohshme të operoj në grumbullimin e mbeturinave në Podujevë dhe sa për informatë tuajën pothuajse jemi e vetmja komunë në Kosovë që kemi lejuar një kompani private të bëjë menaxhimin e mbeturinave. Kjo ka qenë vetëm për një arsyeje, që të futë konkurrencën sepse kemi qenë të vetëdijshtë që menaxhimi i mbeturinave nuk ka qenë në nivel të duhur, ne e falënderojmë Kompaninë “Natyra” që ajo vërtetë e ka futë një konkurrencë dhe Kompania Rajonale për Menaxhimin e Mbeturinave “Pastrimi” kohët e fundit është financuar dhe është pajisur me mekanizëm të ri, kjo nuk është arsyeja pse ne e kemi kërkuar të bëjmë një zonim të ri, ne nuk e kemi larguar Kompani “Natyra”, por kanë qenë vendime të qarta edhe të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë edhe të partnerit kryesor GIZ-it të cilët nuk kanë qenë të gatshëm ta mbështesin një kompani private, madje kanë kërkuar të largojmë nga tregu nëse dëshirojmë të jemi pjesëmarrës në fondet që janë të alokuara për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë. GIZ-i jep 6 milion euro, Qeveria e republikës së Kosovës jep 9 milion

euro për periudhën 2019-2021, dhe ne kemi qenë të shtyrë që të bëjmë një zonim që të mos ketë raste që në një lagje njëra shtëpi të shërbehet nga Kompania “Natyra” kurse tjetra shtëpi nga Kompania “Pastrimi”, pra është deshtë të bëjmë zonim të qartë duke qartësuar kufirin me dy kompanive në fjalë, asaj publike “Pastrimi” dhe asaj private “Natyra”.

Në gjithë këtë proces edhe vet menaxheri i Kompanis “Natyra” ka qenë pjesëmarrës, në fund ai nuk është nda 100% i kënaqur me hapësirën me të cilën jemi marrë vesh që t’i ndahet kësaj Kompanie, mirëpo ai ka qenë pjesëmarrës në të gjithë procesin dhe mund të them lirshëm që punën që e ka bërë “Natyra” vërtet ka qenë e mirë, por nga presioni i madh që e ka bërë Qeveria edhe GIZ-i që të hiqet tërësisht nga tregu, ne kemi rezistuar duke u arsyetuar që Kompania “Pastrimi” ende nuk i ka kapacitetet e plota për të menaxhuar këtë çështje. Për fund, mund të them se kjo është ajo çfarë deshta të jap si informatë, por nëse dëshironi ne mund të bëjmë edhe raport me shkrim.

z.Fitim Haziri, theksoi, i nderuar Nënkyetar , është e vërtetë që na keni ftuar që të marrim pjesë për të shkuar dhe për të bërë homazhe, por ne nuk e kemi parë të arsyeshme të jemi pjesë e ekipit tuaj për të shkuar dhe për të bërë homazhe me ju. Ne nuk i takojmë partisë tënde dhe të vimë mbrapa teje për të bërë homazhe nëpër këto vende që keni qenë, homazhe unë shkoj dhe bëj me parti timen, ndërsa sa i përket programit, Nënkyetari e tha që ka pasë program edhe është postuar – publikuar, programin në ora 19:30. Drama “Room number 13” sipas Ibadete Abazit, unë nuk e di drama si ka qenë por nëse mendoni me kësi fotosh të nderohen Dëshmorët, është no sens.

Program organizativ vitin e kaluar ka pasë, janë nderuar edhe familjarët e Dëshmorëve, me të vërtetë ju duhet ti pranoni ato që ju keni bërë lëshime e jo ti arsyetoni.

Po dal te pika e dytë, sa i përket Kompanisë “Pastrimi”, cilat janë kapacitetet e saj nëse mundesh me na tregu, si dhe këtë rajon që e keni nda për Kompaninë “Pastrimi” a mundet kjo Kompani ta mbuloj menaxhimin e mbeturinave, shembull, në fshatin Sfeçël numri i lagjeve dhe i shtëpive është i madh e që fare mos me shku me marr mbeturinat prej çdo shtëpie, vetëm, vizita të bëhen do t’ia merr tërë kohën e ditës Kompanisë.

z.Arbër Blaku, theksoi, dëshiroj të bëjë publik një shqetësim të bizneseve dhe banorëve të rrugës “Zahir Pajaziti”, deshta një sqarim nga Drejtori. Ne pasi morëm një iniciativë për mbledhjen e nënshkrimeve për një seancë të jashtëzakonshme lidhur me punimet në këtë rrugë dhe sheshit të qytetit e që pata mirëkuptim prej krejt Grupeve të cilët i falënderoj, mirëpo nuk deshta ta sjell njëherë në Kuvend, por deshta që fillimisht Drejtori të na tregojë a do ta parasheh si pik të rendit të ditës për diskutim në seancën e ardhshme, apo ne po thërrasim seancë të jashtëzakonshme, madje qysh tash i mbledhim nënshkrimet. Pra duhet të diskutojmë Drejtor për shkak se shqetësimi është i madh se çka është kah ndodh në rrugën “Zahir Pajaziti” tash e 6-7 muaj, jashtë çdo standardi, është shqetësim jo i jemi por i shumë bizneseve që veprojnë aty, andaj a ka mundësi me ditë çka po ndodh edhe me ma jep fjalën që seancën e ardhshme ka me hy pikë e rendit të ditës për diskutim më gjerësisht.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, përgjigje parafolësit, theksoi, nëse qëllimi është që të diskutojmë për rrugën në fjalë, unë edhe sot mund të diskutojmë por mendoj se ju nuk jeni të përgatitur. Vetëm dëshiroj t’ju tregoj se ai projekt dy vjeçar, e që i bie se deri në muajin dhjetor duhet të përfundoj, por jua them këtu që ajo rrugë është prej rrugëve më të rënda që Podujeva për t’i rregulluar për shkak se ekziston infrastrukturë nëntokësore 40-50 vjeçare që ne nuk i dimë në detaje se çfarë ka aty, por mund t’ju jap me qindra foto të realizuara gjatë punimeve dhe do të bindeni edhe vetë për problemet e shfaqura. Edhe më parë ju kam treguar se 5 herë janë këputur kabllot elektrike që kanë qenë 10 volt dhe të cilat janë shumë të rrezikshme për jetën e punëtorëve, por fati ka qenë me ata punëtor që nuk ka ndodh diçka fatale, madje ka pas raste ku punëtorët nuk kanë guxuar të futen në eskavator për punime, pa dashur të nënkuptohet se po dëshiroj të mbroj Kompaninë punë kryese, kjo është realitet.

Atë rrugë ka mundësi që javën e ardhshme, por duhet të shohë gjendjen ngase dy – tri ditë kam qenë jashtë vendit, ka mundësi që të mbyllet nga Interexi deri tek rreth rrotullimi në magjistrale në mënyrë që të punohet në lidhjet e brendshme sepse kemi sistemin nëntokësor të rrymës, kanalizimit fekal dhe atmosferik, ujësjellësin, dhe të gjitha do të bëhen lidhje të veçanta në mënyrë që ta marrim shembull, jo të ndodh më që qytetarët të shpijnë gypin e ujit dhe të kyçen në të, por do të jenë puseta të veçanta ku do të kyçen qytetarët në ujësjellës, pra duhet të bëhen shkëputje nga ana e majtë në të djathtë dhe anasjelltas ku janë rreth 40-50 shkëputje, me të vetmin qëllim që të përfundoj sa më shpejt, të paktën deri tek interexi. Pra është projekt për një rrugë prej më të rëndave për punime sepse e gjithë infrastruktura do të futet nën tokë.

z.Arbër Blaku, theksoi, unë kërkoja nga Drejtori në mënyrë të qartë, dhe po e përsëris sërish, a ka mundësi që në seancën e radhës të jetë pikë e rendit të ditës kjo rrugë dhe të diskutojmë për atë.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, po problem se mund të diskutojmë në seancën e radhës përkatësisht mund të jetë pikë e rendit të ditës.

z.Blerim Maqastena, theksoi, reagimi i Nënkrjetarit të Komunës z.Nexhmi Rudari, më bërë të marrë fjalën që të shtroj disa pyetje dhe të jap një lloj sqarimi. I nderuar Kryesues, unë personalisht si përfaqësues i Partisë Socialdemokrate nuk jam ftuar për 5 majin Ditën e Dëshmorëve, mirëpo nëse ftohem si anëtar i Kuvendit do të marrë pjesë por nëse ftohem si pjesë e delegacionit të subjekteve atëherë e shqyrtojmë atë. Sa i përket programeve, unë e dalloj programin prej homazheve sepse janë të kundërta. Nëse mendoni se programi bëhet vetëm me një dramë në Teatër dhe e cila nuk është e dedikuar për 5 maj atëherë është problem tjetër. Pastaj turniri në fshatin Kërpimeh është për Dëshmorin Elfir Behrami, pra është tradicional por jo që ju dedikohet Dëshmorëve të Kombit.

Pastaj a mund të më tregoni i nderuari Nënkrjetar se për Betejën e Kaqanollit, cili komision prej Komunës ka qenë pjesëmarrës për herë të fundit, ose Kryetari i Komunës kur ka marrë pjesë për herë të fundit në shënimin e kësaj Beteje, apo edhe në përvjetorin e Betejës së Llapashticës, si dhe çka keni organizuar ju për këto dy Beteja që Llapi krenohet me to. Nëse mund të më tregoni mirë, nëse jo unë ju tregoj se që nga viti 2013, asnjëherë asnjë delegacion i Komunës zyrtarisht nuk ka marrë pjesë në këto dy përvjetorë të këtyre dy Betejave.

znj.Donika Sfishta, Drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit – DKRS, theksoi, meqë u bë temë drama e shfaqur për 5 majin Ditën e Dëshmorëve, unë e them se pikërisht drama ka qenë me tematikë për gratë e dhunuara gjatë luftës, kurse sa i përket fotos që z.Fitim Haziri e shfaqti, unë pyes atë a keni qenë ta shikoni dramën apo i referoheni vetëm fotos.

Sa i përket Betejës së Kaqanollit, nuk di sa ka informacione këshilltari z.Blerim Maqastena, sepse hiq më larg se vitin e kaluar është mbajtur akademi përkujtimore, madje madje janë bërë edhe homazhe në Kaqanoll ku edhe ka qenë një program, kemi marrë pjesë të gjithë ne duke përfshirë edhe Kryetarin, pra kjo ishte vetëm sa për informacion sepse këshilltari i cekur e përmendi vitin 2013 kurse unë fola vetëm për vitin 2018, pa dashur të lëshohem në vitet tjera.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, para vetës e kam një njoftim të cilin dua të bëjë publik sepse ashtu edhe më është kërkuar, fjala është për Grupin e këshilltarëve të PDK-së të cilët më janë drejtuar me këtë njoftim, po e lexoj, *në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së ju njoftojmë se që nga sot si grup politik kemi marrë vendim që z.Rafet Llapashtica të lirohet nga pozita e shefit të grupit politik të PDK-së, dhe nga sot më datë 08.05.2019 z.Rafet Llapashtica nuk përfaqëson Grupin e këshilltarëve të PDK-së në Kuvendin e Komunës së Podujevës.*

Në emër të grupit të PDK-së, shef i Grupit të këshilltarëve nga ky subjekt është caktuar z.Fatmir Rudari, efektive menjëherë. Kërkojmë nga ju (nga Kryesuesi i Kuvendit) që të përditësoni të dhënat tuaja për qëllime të mbarëvajtjes së punës të Kuvendit. Në emër të Grupit, falënderojmë z.Rafet

Llapashticën për punën që ka bërë deri më tani dhe për bashkëpunimin e mëtutjeshëm. Do të thotë janë të nënshkruar 5 këshilltarë/e nga radhët e subjektit PDK dhe të cilët janë prezent në sallë.

Unë si Kryesues i Kuvendit e falënderoj z.Rafet Llapashticën për kontribut, angazhim dhe bashkëpunimin e deritanishëm, dhe në të njëjtën kohë i dëshiroj shëndete, punë të mbarë dhe suksese z.Fatmir Rudarit. Vazhdojmë me diskutuesit tjerë.

znj.Adelina Stublla, theksoi, kam një pyetje për Ekzekutivin e Komunës lidhur me banorët e fshatit Peran, a jeni në dijeni se nuk janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit, kur dihet se fshati Peran është pothuajse sikur lagje e Komunës tonë.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, përgjigje parafolëses, një pjesë e fshatit Peran është e kyçur në ujësjellës, mirëpo tani kapacitetet nga ujësjellësi Batllava do të rriten dhe ka mundësi që edhe pjesa tjetër do të jetë e kyçur në ujësjellës, por kjo varet edhe nga Kompania e Ujësjellësit Batllava e cila është përgjegjëse.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marr fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11;50

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0037921/19

Podujevë,

08 maj 2019

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi